

Raport nga Komisioni për Vlerësimin e skulpturave monumentale

Raport i komisionit për Vlerësimin e skulpturave monumentale

Komisioni për vlerësimin e skulpturave monumentale i formuar me vendim të datës 29.03.2021 nr. protokollit 186 , të Kryetarit të Komunës së Gjilanit z. Lutfi Haziri në përbërje:

1. *Arton Hoxha – kryeses*
2. *Dukagjin Sylejmani – anëtar*
3. *Kaltrina Berisha – anëtare*
4. *Erson Zymeri – anëtar*
5. *Muhamed Sadriu – anëtar*

Raport përfundimtarë i Komisionit për vlerësimin e skulpturave monumentale

Komisioni për vlerësimin e skulpturave monumentale i kryesuar nga z.Arton Hoxha pas ri shpalljes së konkursit ka mbajtur takimin e radhës në hapësirat e galerisë së qytetit ku edhe janë të ekspozuara punimet e konkurrentëve me prezencën e të gjithë pesë anëtarëve të komisionit.

Anëtarët e komisionit kanë analizuar të gjitha punimet e ekspozuara ku gjithsej janë 6 aplikacione:

1. Komisioni nuk do të ndikohet nga asnjë presion i mundshëm për vendime.
2. Punimet e ekspozuara janë analizuar deri në detajin më të vogël nga secili si të pavarur.
3. Punimet të përzgjedhin më votim dhe të respektohet shumica që vendimet të jenë sa më unanime.
5. Anëtarët e komisionit së bashku ti analizojnë punimet dhe gradualisht të arrihet deri të një pajtueshmëri e plote mes anëtarëve të komisionit në mënyrë që përzgjedhja të jetë lehtësisht e realizuar.
7. Meqë komisioni përbehet nga pesë anëtar mënyra e votimit është e lehtësuar dhe vendimet e shumicës janë edhe vendime të komisionit.

Ne takimin e mbajtur me datë 11.08.2021 komisioni ka bërë vlerësimin e të gjitha skulpturave të ekspozuara pas ri shpalljes dhe pas analizave dhe krahasimeve të bëra ka ardhur në

përfundim se asnjë nga punimet ne këto kategori nuk përmbushin kriteret e kërkuara dhe se konkursi duhet te rishpallet për këto kategori:

HEROINAT
GURBETQARI
SPORTISTI
ANDRRA
TOERANCA DHE PAQA
DRAMA

Arton Hoxha – kryesues



Gjilan, 26 gusht 2021